



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 192/6 prot.

Tiranë, më 05.02.2026

REKOMANDIM

Nr. 04, datë 05.02.2026

PËR KONTROLLUESIN “POLICIA E SHTETIT, KOMISARIATI I POLICISË
DEVOLL”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Policia e Shtetit, Komisariati i Policisë Devoll” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 259, datë 26.11.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave z. _____, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është strukturë bazë operationale në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë së Shtetit, i cili ushtron përgjegjësitë e policisë në territorin që ka në juridiksion.
2. Në datën 11.11.2025 dhe 12.11.2025, pranë Zyrës së Komisionerit është paraqitur ankesa e z. _____ përmes së cilës pretendohet se nga Kontrolluesi i janë përpunuar të dhënat në mënyrë të paligjshme, duke i vënë në dispozicion një personi

- të tretë të dhënat e sistemit “TIMS” që lidhen me ankuesin përmes shkresës nr. 1653 prot., datë 24.10.2025.
3. Në kuadër të zgjidhjes së ankesës, Zyra e Komisionerit ka nxjerrë Urdhrin e Hetimit Administrativ nr. 259, datë 26.11.2025, me objekt verifikimin e ankesës së subjektit të të dhënave, .
 4. Në zbatim të detyrave të lëna me Urdhrin e Hetimit Administrativ nr. 259, datë 26.11.2025, grupi i hetimit i përbërë nga inspektorët, z. , dhe z. , më datë 03.12.2025, është paraqitur pranë ambienteve të Kontrolluesit dhe ka kërkuar nga ky i fundit informacion dhe dokumentacion mbi pretendimin e subjektit të të dhënave, z. .
 5. Kontrolluesi gjatë hetimit administrativ është treguar bashkëpunues me grupin e hetimit, dhe lidhur me pretendimin e ankuesit ka deklaruar se informacioni i përcjellë me shkresën nr. 1659/1 prot., datë 24.10.2025, z. , i është përcjellë këtij të fundit mbi bazën e ligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht mbi bazën e nenit 11 të tij.
 6. Referuar procesverbalit të hetimit administrativ, rezulton se Kontrolluesi ka përpunuar të dhënat e ankuesit në kundërshtim me nenin 6 dhe 7 të Ligjit.

Në vlerësimin e ankesës, Zyra e Komisionerit analizon ndërveprimin midis ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit”, ligjit nr. 8793/2001 “Për krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave” dhe ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ligji për avokatinë i njeh avokatit të drejtën t’u drejtohet institucioneve publike për marrjen e dokumenteve të nevojshme për përfaqësimin e klientit të tij, ku kjo e drejtë nuk është absolute dhe zbatohet vetëm brenda kufijve të përcaktuar nga ligjet e tjera materiale. Vetë formulimi i nenit 12/1/a të ligjit për avokatinë “përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë”, i jep përparësi atij legjislacioni që vendos regjim të veçantë të aksesit mbi kategori të caktuara të të dhënave.

Ligji nr. 8793/2001 “Për krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave”, që regjistron dhe administron të dhënat e sistemit “TIMS”, përbën një ligj të posaçëm në këtë kuptim. Ky ligj vendos një strukturë të mbyllur të aksesit, ku marrja, trajtimi dhe shpërndarja e të dhënave lejohet vetëm nga organet proceduese dhe vetëm në funksion të verifikimeve brenda një procedimi penal. Autorizimi për përdorimin e këtyre të dhënave kontrollohet në mënyrë të rreptë nga organet kompetente proceduese dhe mbetet i lidhur me qëllimin për të cilin sistemi “TIMS” është ngritur, pra sigurinë publike dhe kufitare. Në mungesë të një autorizimi të tillë, çdo vënie në dispozicion e të dhënave të “TIMS” përbën shpërndarje të paautorizuar.

Këto kufizime harmonizohen me kërkesat e Ligjit, i cili në nenet 6 dhe 7 parashikon se përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë i; ligjshëm, i domosdoshëm për

qëllimin për të cilin mblidhen, i kufizuar dhe i bazuar në një bazë të qartë juridike. Në rastin konkret, të dhënat e “TIMS” janë mbledhur për funksione të sigurisë publike dhe kufitare, në një sistem të dedikuar që nuk mund të përdoret për qëllime të tjera pa mbështetje ligjore. Dhënia e tyre jashtë përcaktimeve të parashikuara në ligjin e posaçëm, përbën tejkalim të qëllimit fillestar të mbledhjes dhe cenim të parimit të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe konfidencialitetit.

Në këtë prizëm, pretendimi se dhënia e informacionit është kryer mbi bazën e ligjit “Për profesionin e avokatit” nuk gjen mbështetje ligjore, pasi detyrimi i institucionit për t’iu përgjigjur kërkesës së avokatit nuk mund të ushtrohet në kundërshtim me ligjin e posaçëm që rregullon aksesin ndaj sistemit “TIMS”. Për rrjedhojë, Kontrolluesi jo vetëm që nuk ishte i autorizuar t’i jepte informacionin avokatit, por përkundrazi kishte detyrimin ligjor ta refuzonte kërkesën derisa të përmbusheshin kushtet e ligjit të posaçëm. Dhënia e informacionit në mënyrë të paautorizuar përbën shkelje të detyrimeve të parashikuara nga nenet 6 dhe 7 të Ligjit, pasi përpunimi ka tejkaluar kufijtë e ligjshmërisë, ka devijuar nga qëllimi dhe ka cenuar konfidencialitetin e të dhënave.

7. Në vlerësim tërësor të rrethanave të konstatuara gjatë hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vëren se, ndonëse Kontrolluesi ka kryer një përpunim të të dhënave personale në kundërshtim me kërkesat e neneve 6 dhe 7 të Ligjit, ky përpunim nuk rezulton të jetë kryer në mënyrë sistematike, por si pasojë e një interpretimi të gabuar të ndërveprimit ndërmjet legjislacionit për profesionin e avokatit dhe legjislacionit të posaçëm që rregullon aksesin dhe përdorimin e të dhënave të sistemit “TIMS”.

Gjithashtu, gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, Kontrolluesi ka treguar bashkëpunim të plotë me grupin e hetimit, duke vënë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, si dhe duke dhënë shpjegime lidhur me praktikën e ndjekur. Ky bashkëpunim përbën një element lehtësues, i cili evidenton gatishmërinë e Kontrolluesit për të korrigjuar praktikën e tij dhe për t’u përafruar me kërkesat e Ligjit, në përputhje me parimin e përgjegjshmërisë.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit çmon se ndërhyrja me masa parandaluese dhe korrigjuese, përmes dhënies së rekomandimeve konkrete, është një mjet i përshtatshëm dhe proporcional për garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale në të ardhmen. Këto masa synojnë forcimin e kuadrit të brendshëm organizativ të Kontrolluesit, rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit dhe respektimin e parimeve të ligjshmërisë, kufizimit të qëllimit dhe sigurisë së të dhënave, pa qenë e nevojshme, në këtë fazë, vendosja e një sanksioni administrativ.

Për rrjedhojë, në zbatim të neneve 81, 82 dhe 83 të Ligjit, Zyra e Komisionerit vlerëson se dhënia e rekomandimeve përbën një reagim të arsyetuar dhe proporcional ndaj shkeljes së konstatuar, duke i dhënë Kontrolluesit mundësinë të ndërmarrë masa konkrete për parandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen, si dhe duke garantuar një nivel të lartë mbrojtjeje të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi “*Policia e Shtetit, Komisariati i Policisë Devoll*” të marrë masa të menjëhershme organizative dhe procedurale për të garantuar që përpunimi i të dhënave personale, përfshirë ato të administruara në sistemin “*TIMS*”, të kryhet vetëm mbi bazën e një baze të qartë ligjore dhe në përputhje me qëllimet e përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm, në respektim të neneve 6 dhe 7 të Ligjit.
2. Kontrolluesi të sigurojë që çdo kërkesë për vënie në dispozicion të të dhënave personale nga palë të treta të vlerësohet rast pas rasti në raport me legjislacionin e posaçëm që rregullon regjimin e aksesit mbi këto të dhëna.
3. Kontrolluesi të hartojë dhe të zbatojë rregulla të brendshme të qarta për trajtimin, aksesin dhe shpërndarjen e të dhënave personale me karakter të ndjeshëm dhe/ose të dhëna të përpunuara në sisteme të mbyllura, me qëllim parandalimin e përpunimeve të paautorizuara dhe rritjen e nivelit të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave.
4. Kontrolluesi të ndërmarrë masa për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimin e punonjësve përgjegjës për përpunimin e të dhënave personale, lidhur me detyrimet që rrjedhin nga Ligji dhe nga legjislacioni i posaçëm, në zbatim të parimit të përgjegjshmërisë të parashikuar në nenin 6, pika 7, të Ligjit.
5. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, Kontrolluesi të informojë Zyrën e Komisionerit mbi masat e marra për zbatimin e këtij rekomandimi, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.
6. Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 05.02.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi